

DEKLARATË INFORMACIONI PËR VAKSINËN

Vaksina për gripin (live, intranazale): Çfarë duhet të dini

Shumë deklarata me informacion për vaksinën janë të disponueshme në gjuhën spanjolle dhe në gjuhë të tjera. Shih www.immunize.org/vis

Hojas de información sobre vacunas están disponibles en español y en muchos otros idiomas. Visite www.immunize.org/vis

1 Pse të vaksinohesh?

Vaksina e gripit mund të parandalojë gripin.

Grip është një sëmundje ngjitëse që përhapet gjithandej në Shtetet e Bashkuara çdo vit, zakonisht në periudhën midis muajve tetor dhe maj. Kushdo mund ta marrë gripin, por për disa njerëz ai është më i rrezikshëm. Foshnjat dhe fëmijët e vegjël, personat mbi 65 vjeç, gratë shtatzëna, dhe personat me gjendje shëndetësore e të cilëve ka sëmundje bashkëshoqëruese apo me kanë sistem imunitar të dobësuar janë ndër grupet më të rrezikuara nga ndërlikimet e gripit.

Pneumonia, bronkiti, infeksionet e sinusit dhe infeksionet e veshit janë disa shembuj të ndërlikimeve që lidhen me gripin. Nëse keni një gjendje shëndetësore të caktuar me sëmundje bashkëshoqëruese, si sëmundje të zemrës, kancer apo diabet, gripin mund ta përkeqësojë këtë gjendje më tej.

Gripin mund të shkaktojë temperaturë dhe ethe, acarim të fytit, dhimbje të muskujve, lodhje, dhimbje koke, rrufë ose bllokim të hundëve. Disa njerëz, mund të përjetojnë të vjella dhe diarje, ndonëse kjo ndodh më zakonisht me shumë të fëmijët se sa te të rriturit.

Çdo vit, **mijëra njerëz në Shtetet e Bashkuara humbin jetën nga grip**, dhe shumë më shumë të tjerë shtrohen në spital. Vaksina e gripit parandalon miliona vizita te mjeku për sëmundje dhe ato që kanë lidhje me gripin çdo vit.

2 Vaksina e dobësuar e gripit

CDC-ja rekomandon që kushdo që nga mosha 6 muajshe e më tej të vaksinohet në çdo sezon grip. **Fëmijët 6 muajsh deri në 8 vjeç** mund të kenë nevojë për 2 doza gjatë një sezoni të vetëm grip. **Gjithë të tjerët** kanë nevojë për vetëm 1 dozë në çdo sezon grip.

Vaksina e dobësuar e gripit (njohur si LAIV) është një vaksinë me spjeg në hundë që mund t'u jepet personave që nuk janë shtatzënë dhe që janë të moshës **2 deri në 49 vjeç**.

Zhvillimi i mbrojtjes pas vaksinimit kërkon rreth 2 javë.

Ka shumë viruse grip, dhe ata janë në ndryshim të vazhdueshëm. Çdo vit, bëhet një vaksinë e re

për mbrojtje ndaj tre apo katër viruseve që kanë gjasë të shkaktojnë sëmundje në sezonin e ardhshëm të gripit. Edhe në rastet kur vaksina nuk përputhet plotësisht me këto viruse, ajo përsëri mund të ofrojë mbrojtje në një nivel të caktuar.

Vaksina e gripit **nuk shkakton grip**.

Vaksina e gripit mund të bëhet njëkohësisht me vaksina të tjera.

3 Flisni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor.

Tregojini ofruesit të vaksinës nëse personi që do të vaksinohet:

- Është **më i vogël se 2 vjeç dhe më i madh se 49 vjeç**.
- Është **shtatzënë**.
- Ka pasur një **reaksion alergjik pas një doze të mëparshme të vaksinës së gripit**, ose ka ndonjë **alergji të rëndë kërcënuese për jetën**.
- Është **fëmijë ose adoleshent i moshës 2 deri në 17 vjeç që po merr aspirinë apo produkte me përmbajtje aspirine**.
- Ka një **sistem imunitar të dobësuar**.
- Është **fëmijë i moshës 2 deri në 4 vjeç që ka astmë ose një histori të vështirësisë në frymëmarrje në 12 muajt e fundit**.
- Ka **marrë mjekim antiviral të gripit në 48 orët e mëparshme**.
- **Kujdeset për persona me imunitet të kompromentuar rëndë** për të cilët kërkohet një mjedis i mbrojtur.
- Është **5 vjeç ose më i rritur dhe ka astmë**.
- Ka **gjendje të tjera mjekësore bashkëshoqëruese** që mund t'i vendosin njerëzit në rrezik për komplikacione të rënda nga grip (si për shembull **sëmundje e mushkërisë, sëmundje e zemrës sëmundje e veshkave, çrregullime të veshkës apo të mëlçisë, çrregullime neurologjike ose neuromuskulare ose metabolike**).
- Ka pasur **Sindromën Guillain-Barré** brenda 6 javëve pas dozës së mëparshme të vaksinës së gripit.



Në disa raste, ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor mund të vendosë ta shtyjë vaksinimin për gripin deri në një vizitë të dytë në të ardhmen.

Për disa pacientë, mund të jetë më e përshtatshme një vaksinë tjetër (vaksina e çaktivizuar ose rikombinuere) se sa vaksina e dobësuar e gripit.

Personat me sëmundje të lehta, si për shembull një i ftohtë, mund të vaksinohen. Personat që janë sëmurë në një masë të moderuar apo të rëndë zakonisht presin deri sa të rimëkëmben para se të bëjnë vaksinën e gripit.

Ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor mund t'ju japë më shumë informacion.

4 Rreziqet e një reaksioni nga vaksina

- Rrufë ose kongjestion i hundës, marrje fryme dhe dhimbje koke janë simptoma që mund të ndodhin pas LAIV-it.
- Të vjella, dhimbje muskujsh, temperaturë, acarim i fytit, dhe kolla janë efekte të mundshme anësore.

Nëse ndodhin këto probleme, ato zakonisht fillojnë shumë shpejt pas vaksinimit dhe janë të lehta dhe zgjasin pak kohë.

Ashtu sikurse edhe me çdo barnë, ka një mundësi shumë të largët që vaksina të shkaktojë një reaksion të rëndë alergjik, lëndime të tjera serioze, apo vdekje.

5 Çfarë ndodh në rast se ka një problem serioz?

Një reaksion alergjik mund të ndodhë pas largimit të personit nga klinika. Nëse shihni shenja të një reaksioni të rëndë alergjik (urtikarie, ënjtje të fytyrës dhe të fytit, vështirësi në frymëmarrje, rrahje të shpejta të zemrës, marrje mendsh, apo dobësi), telefononi urgjencën **9-1-1** dhe çojeni personin në spitalin më të afërt.

Për shenja të tjera që janë shqetësim për ju, telefononi ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor.

Reaksione të dëmshme negative duhet të raportohen në Sistemin e Raportimit të Ngjarjeve të Dëmshme Negative nga Vaksina (VAERS). Zakonisht, këtë raport e dërgon ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor, por mund ta bëni edhe vetë. Vizitoni faqen e internetit të VAERS-it

www.vaers.hhs.gov ose telefononi **1-800-822-7967**. VAERS shërben vetëm për raportimin e reaksioneve, dhe stafi i VAERS-it nuk japin këshilla mjekësore.

6

Programi Kombëtar i Kompensimit nga Dëmtimet prej Vaksinës

Programi Kombëtar i Kompensimit të Dëmeve nga Vaksina (VICP) është një program federal që u krijua për të kompensuar personat që mund të jenë dëmtuar nga vaksina të caktuara. Vizitoni faqen e internetit të VICP-së **www.hrsa.gov/vaccinecompensation** ose telefononi

1-800-338-2382 për të mësuar më tepër për programin dhe për paraqitjen e një kërkesë për kompensim. Ka një limit për paraqitjen e një kërkesë për kompensim.

7

Si mund të mësoj më tepër?

- Pyesni ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor.
- Telefononi departamentin e shëndetit lokal po atë shtetëror.
- Kontaktoni Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC):
 - Telefono **1-800-232-4636 (1-800-CDC-INFO)** ose
 - Vizito faqen e internetit të CDC-së **www.cdc.gov/flu**

Vaccine Information Statement (Interim)
**Live Attenuated
Influenza Vaccine** Albanian



Office use only

8/15/2019 | 42 U.S.C. § 300aa-26